

UDHËZIM
Nr. 4, datë 29.2.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 45, DATË 19.12.2011 “PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“2. Studentët e marrin numrin e matrikullimit (NIM) të përbërë nga tri germa dhe tri shifrat të kodit të regjistrimit dhe gjashtë shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

2. Pika 5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga tri germa dhe tri shifra. Germa e gjashtë e kodit të regjistrimit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

3. Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 që i bashkëlidheshin udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” zëvendësohet me shtojcën nr. 2 dhe shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj